

KËRKESË

Nr. 7448/5, datë 10.5.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Zgjerim i hapësirës së varrezave në fshatin Shenepremte”, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.

Subjekti kërkues është Bashkia Divjakë. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 109 200 (njëqind e nëntë mijë e dyqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E
PROJEKTTIT
“ZGJERIM I HAPËSIRËS SË VARREZAVE NË FSHATIN SHENEPREMTE”, NJËSIA ADMINISTRATIVE
TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasuris ë	Zona kadastrale	Sipërfaqja tokë arë/m²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Faslli Kasmi	473/1	3341	300	109,200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI				109,200	